



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/906
Datë: 27/9/2024

Mbështetur në nenin 17 të Kodit të Etikës për stafin akademik të Universitetit të Prishtinës (Nr. 1/751, dt. 19/07/2013), Rregullave të punës të Këshillit të Etikës, nr. 1/629, datë 14.07.2016, Rregullores për Masat dhe Procedurat Disiplinore ndaj Personelit Akademik të Universitetit të Prishtinës si dhe në bazë të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Këshilli i Etikës, njëzëri, në mbledhjen e mbajtur me datën 25.09.2024, mori vendim që t'i rekomandoj Senatit të Universitetit të Prishtinës, të miratoj këtë:

VENDIM

- I. Degradim/ulje të gradës akademike për z. Enver Hasani nga grada e Profesorit të rregullt në Profesor të asocuar.**
- II. Revokimi i mirënjohjeve dhe privilegjeve honorifike të z. Enver Hasani si ish-Rektor i Universitetit të Prishtinës.**
- III. Mohim i pjesëmarrjes të z. Enver Hasani në komisione profesionale për tri vite si dhe përfshirjes në mentorim të të gjitha niveleve për një vit vijues duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.**
- IV. Vërejtje me shkrim. Ky vendim nënkupton vërejtje me shkrim. Z. Enver Hasani do të përmbahet nga çfarëdo përdorimi i gjuhës së papërshtatshme, fyese, pa takt akademik dhe denigruese ndaj personelit dhe punëdhënësit, Universitetit të Prishtinës.**

Arsyetim

I. Gjendja faktike

Me datë 26.08.2024, Këshilli i Etikës i Universitetit të Prishtinës ka pranuar "Denoncimin (Nr.prot.3/293) për shkelje të rënda të Kodit të Etikës të Universitetit të Prishtinës dhe obligimeve akademike nga Prof. Enver Hasani, bazuar në Raportin e monitorimit nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), si dhe fakteve dhe provave tjera relevante", të parashtruar nga Dekani i Fakultetit Juridik të UP-së, Prof. Asoc. Avni Puka.

L. M.

Ky denoncim përmban pretendimet për shkelje, të ndarë në tri pika kryesore, përkatësisht pretendime:

Pika I e denoncimit: Mos mbajtja e ligjëratave gjatë gjithë vitit akademik 2023/2024 dhe vënia në lajthim e institucionit duke u kompensuar për normë dhe mbi normë pa mbajtur mësim sipas obligimeve kontraktore.

Sipas këtij pretendimi, është konstatuar se Prof. Enver Hasani nuk ka qenë prezent në ligjëratë sipas orarit të shpallur, dhe pastaj pas kërkesës për sqarime është konstatuar se Prof. Hasani nuk ka mbajtur mësim/ligjëratë gjatë gjithë vitit akademik 2023/2024.

(Provë: Raporti i Monitorimit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), të realizuar në Fakultetin Juridik të UP-së me datë 14.05.2024).

Kjo është konfirmuar edhe nga zyrtari për mësim me datë 15.05.2024, kurse nga Prodekani për mësim është konfirmuar se raportet e orëve për mbajtjen e ligjëratave në emër të Prof. Hasani janë dorëzuar çdo muaj në adresën elektronike mesimi.juridik@uni-pr.edu (sikurse i gjithë personeli tjetër akademik i fakultetit) dhe mbi këtë bazë janë përgatitur raportet për pagesën e orëve në kuadër të normës dhe mbi normës dhe janë proceduar me rregull nga ana e Zyrës së Dekanit. Në këtë mënyrë, duke mos e njoftuar asnjëherë për mungesën dhe mos mbajtjen e ligjëratave, z. Hasani ka vënë në lajthim dhe ka mashtruar gjatë gjithë kohës Zyrën e Dekanit të Fakultetit Juridik.

Sipas *Raporti i Monitorimit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim*, të realizuar në Fakultetin Juridik të UP-së me datë 14.05.2024, kjo Agjenci kishte kërkuar edhe nga Rektorati nëse z. Hasani kishte marrë ndonjë vendim/leje nga instancat kompetente vendimmarrëse të UP për mungesën e tij. Mirëpo, është konfirmuar edhe fakti se z. Hasani nuk ka njoftuar, nuk ka bërë kërkesë dhe as nuk ka asnjë vendim nga Fakulteti apo Rektorati për mos mbajtje të mësimi (mungesën nga puna) dhe as për zëvendësim të orëve nga profesorët e tjerë, në emër të z. Hasani. Sipas këtij Raporti, më saktësisht është konstatuar se:

“Prof. Hasani nuk ka mbajtur ligjëratë gjatë gjithë vitit akademik 2023/2024, se nuk ka pas asnjë vendim për këtë, as nga autoritet e UP-së dhe për këto orë është paguar. Prof. Hasani është deklaruar në E-Akreditimi në fillim të vitit akademik 2023/2024 si staf i rregullt në Fakultetin Juridik përfshirë edhe orët që i mban. Gjithashtu në vlerësimin final të raportit të AKA-së theksohet se Prof. Hasani përveç si staf i rregullt në Fakultetin Juridik, është edhe bartës i programit “European Advanced Studies” me vërejtjen se përmes Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) do të këtë ndikim edhe të programi. Ndërsa, për përgjegjësinë e Prof. Hasani për mungesën e mbajtjes së ligjëratave raporti i monitorimit të AKA-së e adreson në mekanizmat e brendshëm të UP-së.

Sipas të dhënave financiare konstatohet se z. Hasani gjatë vitit akademik 2023/2024 (01.10.2023 - 31.05.2024) është paguar për normë dhe mbi normë, në shumën prej 15,171.29 Euro (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e një euro e njëzet e nëntë cent).

(Provë: Pasqyra e të ardhurave personale nga Shërbimi i Financave, me nr.prot 03/278, dt.26.08.2024).

Pika II e Denoncimit: Marrja e thirrjeve akademike në mënyrë të kundërligjshme duke mos respektuar kohëzgjatjen e thirrjeve paraprake sipas Statutit, gjatë kohës sa ka qenë Rektor i Universitetit.

Sipas provave të bashkangjitura konstatohet se z. Hasani pas zgjedhjes Rektor i UP-së me datë 29.06.2009, është avancuar në dy thirrje akademike. Një muaj pas zgjedhjes Rektor, z. Hasani

duke qenë edhe kryesues i Senatit, me datë 28.07.2006 është avancuar në thirrjen e Profesorit të asocuar. Pa kaluar periudha katër (4) vjeçare, nga avancimi i fundit është emëruar me datë 30.06.2009, në gradën e Profesorit të Rregullt, që nënkupton brenda një periudhe me pak se 3 vite.

Sipas Statutit të Universitetit të Prishtinës të vitit 2004, neni 183, përcaktohet se gradat shkencore dhe emërimet në tituj zgjasin për periudhën katër (4) vite.

(Provë: - *Vendimi i zgjedhjes së Prof. Enver Hasani Rektor i UP-së me nr.prot.1/119 dt.29.06.2006;*

- *Vendimi i emërimit të Prof. Hasani Profesor i asocuar, me Ref.nr. 1/296 dt.03.08.2006;*

- *Vendimi i emërimit të Prof. Hasani Profesor i rregullt, me Ref.nr. 2/306 dt.8.7.2009;*

- *Kontrata e punës e Prof. Hasani me nr.2/474, dt.15.7.2009 dhe*

- *Statuti i UP-së i vitit 2004, dhe faqja ku është neni 183 i Statutit.).*


Pika III e Denoncimit: Dëmtimi i vazhdueshëm i imazhit të Fakultetit dhe Universitetit të Prishtinës. Sipas këtij pretendimi, theksohet se ruajtja e prestigjit të Universitetit të Prishtinës është obligim kontraktor i përcaktuar edhe në kontratën e punës për secilin staf akademik, dhe në këtë rast dhe për z. Hasani. Një obligim i tillë është i përcaktuar edhe me Kodin Etik dhe rregulloret në fuqi që përcakton shkeljet disiplinore të rënda.

(Provë: *Kontrata e Punës e Z. Hasani Nr.2/474 e datës 15.07.2009).*

Sipas dëshmime të bashkangjitura, z. Hasani në mënyrë publike dhe të përsëritur përmes mediave të ndryshme elektronike dhe audiovizuele, ka dhënë deklaratë të ndryshme, ku shihet se disa prej tyre kanë për objekt institucionet publike të Republikës së Kosovës përfshirë Universitetin e Prishtinës, por edhe kolegët profesorë dhe në veçanti dekanin e Fakultetit Juridik. Disa prej tyre, janë përmbledhur si në vijim (citim):

“Statuti është bërë në mënyrë tërësisht okulte, nga një grup që tu hëngër tu pi kafeve. Sot Universiteti ka ardhë në gjendje, prej Dervish Rozhajës e Gazmend Zajmit, jetën akademike ta udhëheqin një grup i njerëzve që nuk dinë ku është veriu ku është jugu...”; “Avancimet Akademike në Universitet i ka marrë rruga. Tek ne mbledhen një grup atje.. nuk e bën senati, d.m.th këto krejt caktohen jashtë senatit akademik. Këtë proces nuk e bën ligji,; Por aktet nënligjore që i hartojnë njerëzit tu pi kafe dhe tu hanger nëpër restorane dhe i caktojnë kriteret.. andaj këto i ka kap rruga...”; “Një pjesë e tyre janë pjesë e atyre që unë i kam prurë në Universitet.. jo që i kam prurë por edhe gratë ja kam punësuar disave..”; “...niveli i doktoratës së saj është tmerr...ky as punim seminarik nuk është, jo për doktoraturë...është zhgl dhe plagjiat”; “nuk e ka të qartë se çfarë paraqet e drejta kushtetuese”; “...e kam marrë prej rruge sepse është kristian.”; “Lopë, qyqan... unë jam Baba”; “...rrugaçëri ordinere..” apo “...analfabete ordinere..”; “...ky grupacion që unë në vazhdimësi e kam cilësuar si grupacion kriminal”; etj.

II. Procedura para Këshillit të Etikës



Me datë 27.08.2024, Këshilli i Etikës ka shqyrtuar denoncimin ndaj z. Hasani dhe duke u bazuar në kuadrin normativ përkatës ka filluar procedurën e shqyrtimit të lëndës, fillimisht me

shqyrtimin paraprak të denoncimit dhe zhvillimin e procedurës për komunikimin e shkresave dhe dëgjimin e palëve në çështje.

Me datën 27.08.2024 nga zyrtarja e Rektoratit, në emër dhe me autorizim të Këshillit të Etikës i është dërguar z.Hasani kërkesa mbi mundësinë dhe të drejtën për deklaram në lidhje me pretendimet ndaj tij, në afatin prej 15 ditëve. Në këtë rast, i është dërguar Denoncimi si dhe provat e bashkangjitura.

(Provë: E-mail i Këshillit të Etikës i datës 27.08.2024)

Më datën 29.08.2024, z. Hasani përmes e-mail, kërkon që të përjashtohet kryesuesi i Këshillit të Etikës, dhe se pjesa për mësimdhënie duhet të ndahet dhe të trajtohet nga prokuroria sepse është çështje penale.

(Provë: E-mail i Z. Hasanit i datës 29.08.2024)

Me datën 29.08.2024, nga zyrtarja e Rektoratit, në emër dhe me autorizim të Këshillit të Etikës, janë kërkuar nga Fakulteti Juridik, përkatësisht Prodekani për mësim, raportet e orëve të mbajtjes së ligjëratave në emër të z.Hasani.

(Provë: E-mail i Këshillit të Etikës i datës 29.08.2024)

Me datën 02.09.2024, nga Prodekani për mësim z.Muçaj janë dërguar përmes e-mailit: *Raportet (listat e evidencës) e mbajtjes së mësimit për z.Enver Hasani; Emailat ku personelit akademik i është kërkuar secilin muaj, respektivisht Tetor 2023-Maj 2024 dorëzimi i listave/raportit të orëve të mbajtura; dhe Emailat e dërgimit të listave të evidencave për Profesorin në fjalë.*

(Provë: E-mail i z.Muçaj i datës 02.09.2024)

Më datën 31.08.2024, z. Hasani, përsëri përmes e-mailit, thekson që meqë pjesa penale (gjithnjë sipas tij) do të trajtohet nga Prokuroria sipas modelit të rastit të fundit për ngacmim seksual. Po ashtu kërkon që t'i plotësohet kërkesa që çdo seancë të jenë të pranishëm mediat dhe publiku. Dhe në fund të email-it akuzat e prof. Puka i cilëson fiktive dhe të sajura.

(Provë: E-mail i Z. Hasanit i datës 31.08.2024)

Më datën 06.09.2024, Z. Hasani, përmes e-mail, njofton për paraqitje të Kallëzimit Penal në prokurori.


(Provë: E-mail i Z. Hasanit i datës 06.09.2024)

Me datën 13.09.2024, në mbledhjen e mbajtur të Këshilli i Etikës në mënyrë unanime ishte vendosur për të gjitha kërkesat e z. Hasani për këtë fazë të procedurës.

(Provë: Vendimi i Këshillit të Etikës për aspektet procedurale, datë 13.09.2024).

Me datën 09.09.2024, z. Hasani ka dërguar e-mail Këshillit të Etikës se nuk mund të marr pjesë në seancën e drejtpërdrejt para Këshillit të Etikës të thirrur me datë 13.09.2024 për të dhënë dëshminë e tij për shkaqe shëndetësore.

(Provë: E-mail Z. Hasanit i datës 09.09.2024)



Me datën 09.09.2024, Këshilli i Etikës i dërgon përsëri e-mail z. Hasani, se për këto arsye Këshilli i Etikës do të iu mundësoj që këtë seancë ta realizojmë edhe në mënyrë virtuale (*online*).

(Provë: E-mail i Këshillit të Etikës i datës 09.09.2024)

Me datën 09.09.2024, z. Hasani dërgon përsëri e-mail dhe refuzon pjesëmarrjen në seancë për shkak të natyrës së sëmundjes dhe se vetëm pas tri javëve mund të jap përgjigje. Në të njëjtën kohë përmend edhe konfliktin e interesit me Kryesuesin, z. Morina dhe përjashtimin e tij. Në fund, kërkon që të mos kontaktohet më tutje për këtë çështje.

(Provë: E-mail i Z. Hasanit i datës 09.09.2024)

Kështu që, në datën e seancës me 13.09.2024, ishte paraqitur vetëm pala denoncuese dekani z. Puka dhe prodekani z. Muqaj, sipas ftesës se Këshillit të Etikës.

(Provë: Procesverbali i mbledhjes i datës 13.09.2024)

III. Baza juridike e vendimit nga ana e Këshillit të Etikës

Në pajtim me nenin me 17 të Kodit të Etikës, Këshilli i Etikës ka të drejtën dhe përgjegjësinë për të zhvilluar procedurën për çështjet e paraqitura me denoncim dhe për të vendosur meritorisht. Këshilli i Etikës vepron me objektivitet dhe paanshmëri duke zbatuar me rigorozitet kornizën normative të Universitetit të Prishtinës dhe standardet më të avancuara për sigurimin dhe promovimin e një ambienti akademik të qetë, të dinjitetshëm dhe profesional.

Këshilli i Etikës është komision i pavarur i UP, i cili udhëhiqet nga, sidomos këto akte juridike:


- *Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës;*
- *Ligji i punës;*
- *Statuti i UP, i nxjerrë në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës;*
- *Kodi i Etikës i stafit akademik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", nr. 1/751, datë 19.07.2013;*
- *Rregullore pune e Këshillit të Etikës, nr. 1/629, datë 14.07.2016;*
- *Rregulloren për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të UP, nr. 857, datë 11.04.2017.*

Sipas nenit 6 të Rregullores për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të UP, nr. 857, datë 11.04.2017 është përcaktuar që:

"Shkelja e rëndë konsiderohet çdo shkelje e cila esencën e marrëdhënies së punës për personelin akademik në Universitetin e Prishtinës, pasojë e të cilit është një dëm vështirë i riparueshëm. Shkelje e rëndë disiplinore konsiderohet:

1.1 Shkelja e rëndë e Kodit të Etikës;

1.2 Çdo shkelje e konfirmuar e ligjeve përkatëse që tangojnë fushën e universitetit dhe punës akademike në të;



1.13 Mos përmbushja e qëllimshme apo përmbushja qartazi e pakënaqshme e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara me kontratë apo vendim;....

1.18 Kryerja e aktiviteteve që bien ndesh me interesat e institucionit apo veprimet që e dëmtojnë institucionin;...

1.25 Ngacmimi i çdo lloji, duke abuzuar me dinjitetin e një personi në mënyrën që shkakton armiqësi ose frikë të çdo person në vendin e punës”

Sipas nenit 11 (Marrëdhëniet me kolegë – parimet etike) të Kodit të Etikës të Universitetit të Prishtinës është përcaktuar që:

“Si kolegë, stafi akademik ka detyrime që rrjedhin nga anëtarësia e përbashkët në bashkësinë e dijetarëve. Profesorët nuk i diskriminojnë apo nuk i ngacmojnë kolegët e tyre. Ata i respektojnë dhe i mbrojnë hulumtimet e lira të bashkëpunëtorëve. Në këmbim të kritikave dhe ideve, profesorët e tregojnë respektin e duhur për mendimet e të tjerëve, ndërkohë që ushqejnë kulturën e dialogut argumentues. Profesorët duhet të jenë objektiv në gjykimin e tyre profesional ndaj kolegëve. Profesorët e pranojnë pjesën e tyre të përgjegjësisë për qeverisjen e institucionit. Stafit akademik i mentoron kolegët e rinj dhe i ndihmon ata në mësimdhënien e tyre dhe në zhvillimin e tyre shkencor. Profesorët dhe i tërë stafi mësimdhënës kanë detyrë morale për të raportuar sjelljen joetike të kolegëve të tyre ose shkeljen e dispozitave të këtij Kodi.”

Sipas nenit 13 (Përgjegjësia ndaj Universitetit – parimet etike) të Kodit të Etikës, është përcaktuar që:

“Stafit akademik i promovon vlerat njerëzore, reputacionin e profesionit dhe të komunitetit akademik përmes deklaratave dhe veprimeve publike, që e ruajnë integritetin dhe dinjitetin e Universitetit. Ata i kryejnë detyrat e tyre sipas njohurive të tyre më të mira, ndërgjegjes dhe ndershmërisë, si dhe me përkushtim. Profesorët i respektojnë rregulloret e deklaruara të institucionit, si dhe gëzojnë të drejtën e tyre për të krijuar dhe për të kërkuar rishikim të rregulloreve. Në rastin e angazhimit jashtë Universitetit, karakteri dhe niveli i angazhimit të anëtarit të stafit akademik është në përputhje me punën dhe interesat e institucionit. Stafit akademik është i vetëdijshëm për konfliktin e interesit dhe për pajtueshmëritë e funksioneve të tjera publike e private dhe aktiviteteve të tjera, duke pasur parasysh dhe duke i ruajtur interesat më të mira të Universitetit”

Sipas nenit 14 (Përgjegjësi ndaj Universitetit – sjellja e papranueshme), paragrafi 4, është përcaktuar që:

“...ngacmimi ndaj një anëtari tjetër të komunitetit të Universitetit, që e pengojnë punën dhe aktivitetin universitar të atij personi. Këtu përfshihet lobimi, shantazhi, zhvatja, rryshfeti dhe korrupsioni, si dhe forma të tjera të veprave të pandershme, që shkelin standardet e profesionit akademik.”

L. M.

IV. Vlerësimi i gjendjes juridike dhe faktike

Bazuar në provat e cekura më lartë dhe dispozitat e Rregullores së punës, Këshilli i Etikës ka zhvilluar procedurën konform kornizës normative duke respektuar me rreptësi parimet fundamentale për një proces objektiv dhe të paanshëm. Këtu mund të theksohen sidomos trajtimi me dinjitet të palës dhe çështjes si dhe sigurimin e parimit të dëgjimit të palës (sidomos dispozitat e nenit 4 të Rregullores pune e Këshillit të Etikës, nr. 1/629, datë 14.07.2016).

Përkundër asaj se pala e denoncuar, z. Hasani, nuk i përgjigjet ftesës për pjesëmarrje të drejtpërdrejt në seancë, me prezencë fizike ose virtualisht (siç është njoftuar dhe ftuar nga Këshilli i Etikës). Vlen të theksohet se në të gjitha deklaratimet me shkrim nga z. Hasani, në adresë të Këshillit të Etikës, në asnjë rast nuk është deklaruar në lidhje me pretendimet kundrejt tij të paraqitura në denoncime, dhe nuk ka dërguar asnjë fakt apo provë që i kundërshton të njëjtat. Z. Hasani duke mos u paraqitur në seancë, jo vetëm që nuk shfrytëzon të drejtat e tij procedurale, por, në të njëjtën kohë nuk kryen edhe një obligim të tij institucional për t'iu përgjigjur pozitivisht kërkesave të institucionit dhe punëdhënësit të tij, të cilin e ka obligim ligjor me Ligjin për procedurën administrative. Në disa raste, edhe gjatë zhvillimit të procedurës, z. Hasani refuzonte thirrjen e Këshillit të Etikës për prezantim të kundërshtimeve të tij dhe deklarim, me arsyetimin për shkaqe shëndetësore, ndërsa në anën tjetër, në të njëjtën kohë merrte pjesë edhe fizikisht në intervista televizive.

Këshilli i Etikës thekson me vendosmëri edhe njëherë se pjesëmarrja dhe deklarimi në ftesa të organeve të Universitetit nuk është vetëm e drejtë elementare procedurale e secilës palë, por është edhe detyrim i anëtarit të personelit akademik dhe jo akademik për bashkëpunim dhe përgjegjësi institucionale.

Z. Enver Hasani jo vetëm që nuk ka bashkëpunuar me organet legjitime të Universitetit për çështjen e referuar, por ai ka sabotuar dhe përbuzur në vazhdimësi me Institucionin si punëdhënësi i tij. Kjo bie ndesh direkt me detyrimet statutare dhe kontraktore të tij dhe një qasje e tillë e tij nuk mund të tolerohet. Edhe në këtë pikë, Universiteti proteston në mënyrën më të ashpër kundër një sjellje të tillë përbuzëse të një anëtarit të personelit akademik ndaj punëdhënësit të vetë.

Përkundër kësaj, Këshilli i Etikës thekson se ka ndërmarr të gjitha masat që trajtimi i palës dhe çështjes të zhvillohet me dinjitet, i është dhënë mundësia për paraqitjen e kundërshtimeve dhe provave, si dhe është siguruar mbajtja e seancave dëgjimore. Për shqyrtimin e kësaj çështje, Këshilli i Etikës ka organizuar disa seanca. Meqë pala e denoncuar ka refuzuar qartazi pa asnjë

L. M.

bazë për bashkëpunim, Këshilli është rezervuar në konvokimin edhe të seancës së dytë dëgjimore.

KE ka shqyrtuar denoncimin dhe ka vlerësuar se për secilën pikë të pretendimeve është i nevojshëm shqyrtimi i veçantë, edhe pse proceduralisht mund të zhvillohet një procedurë. Varësisht nga pikat e pretendimeve, është realizuar shqyrtimi procedural dhe substancial i pretendimeve dhe për këto është arritur në konstatime si më poshtë:

- *Pika I e Denoncimit:*

KE ka shqyrtuar pikën e parë të denoncimit. Pretendimi është se z. Hasani në tërë vitin akademik 2023/24 nuk ka mbajtur as edhe një ligjëratë të vetme dhe se për këtë mosrespektim të detyrës kontraktore, z. Hasani nuk ka pasur ndonjë leje apo lirim për mos mbajtje të mësimit nga Menaxhmenti i Fakultetit apo edhe i Universitetit.

KE ka konstatuar se mbajtja e ligjëratave në mënyrë të rregullt është detyrim i padiskutueshëm statutar dhe kontraktor i secilit anëtar të personelit akademik. Mos mbajtja e ligjëratës mund të jetë rast tejte përjashtimor dhe atë për shkaqe dhe arsye legjitime, të cilat arsyetime duhet të jenë bindëse. KE vënë re poashtu se zëvendësimi i kolegut në ligjëratë përbën liri akademike, por ky zëvendësim mund të jetë në ndonjë rast të veçantë dhe të jashtëzakonshëm. Zëvendësimi i kolegut në tërë semestrin apo edhe më pak në tërë vitin akademik përbën rast tjetër institucional dhe për këtë situatë duhet të vihen në dijeni Menaxhmenti dhe organet përgjegjëse të Universitetit dhe atë me lejen dhe vendimin përkatës.

Këtë pretendim të denoncuesit, pala e denoncuar nuk e ka kundërshtuar me asnjë provë apo fakt. Për më tepër, vërtetohet se pala e denoncuar z. Hasani, për mungesën dhe mos mbajtjen e ligjëratave nuk kishte marr asnjëherë leje apo vendim nga organet kompetente të Universitetit të Prishtinës. Dhe me këtë, duke shkelur rëndë obligimet kontraktuale së pari, por edhe rregullat etike të sjelljes institucionale për njoftim të eprorëve dhe Dekanit, të përcaktuara me Rregulloren për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të Universitetit të Prishtinës, nr. 857, datë 11.04.2017 dhe Kodin e Etikës të stafit akademik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", nr. 1/751, datë 19.07.2013. Pretendimet e z. Hasani se elementet e mashtrimit të pretenduara nga dekani z. Puka përbëjnë vepër penale dhe jo etike, Këshilli i Etikës i bënë me dije se objekt i trajtimit në këtë Këshill, nuk do të jenë elementet e veprës penale të mashtrimit, mirëpo, vetëm çështja e mos mbajtjes së ligjëratave si obligim kontraktual dhe statutar që z. Hasani e ka me institucionin e Universitetit të Prishtinës në bazë të kontratës së punës. Mos njoftimi i Dekanatit për mungesën në punë për një kohë më të gjatë paraqet injorim ndaj institucionit. Përkundër arsyeve shëndetësore për këtë mungesë, të deklaruar nga z. Hasani (nuk është prezantuar ndonjë dëshmi apo raport mjekësor), e të cilat janë plotësisht të mirë kuptueshme, por edhe për mungesat e kësaj natyre, ka rregulla të caktuara. Ato duhet të paraqiten në mënyrën dhe procedurën e paraparë me ligj, përfshirë

edhe aktet normative të Universitetit. Duke marrë në konsideratë kriteret ligjore në fuqi, mungesa e z. Hasani në vendin e punës dhe mbajtjen e ligjëratave për një vit të tërë akademik pa ndonjë vendim lirues është bazë për shqyrtimin e masës me të rëndë të shkëputjes së marrëdhënies së punës me Universitetin.

Përkundër kësaj situate, KE nuk ka arritur të konstatojë përfundimisht përtej çdo dyshimi për shkeljen e rëndë të detyrave të punës. Në këtë proces të monitorimit është përfshirë edhe Agjencia e Kosovës për Akreditim, e cila edhe ka hartuar një raport dhe ka marrë informacione se ligjëratat nuk janë mbajtur sipas planprogramit të paraqitur dhe të aprovuar. Gjithashtu, KE nuk ka arritur në përfundimin se në çfarë baze është realizuar zëvendësimi i ligjëratave nga kolegët dhe atë në tërë vitin akademik dhe atë pa njoftuar Dekanatin.

Për këto arsye, KE ka arritur në konstatimin se për këtë pikë të pretendimeve nevojiten informata shtesë dhe bashkëpunim sidomos të Agjencinë së Kosovës për Akreditim për të vendosur meritorisht sipas kornizës normative. Me këtë pezullohet procedura para KE me përbërje aktuale dhe me këto pretendime do të merret KE me përbërje të re.

- *Pika II e denoncimit:*

Këshilli i Etikës, lidhur me *Pikën II të Denoncimit* konstaton se z. Hasani ka marr gradën Profesor i rregullt në kundërshtim me kriterin e nenit 183 të Statutit të Universitetit të Prishtinës të vitit 2004, i cili kishte përcaktuar që gradat shkencore dhe emërimet në tituj zgjasin për periudhën katër (4) vite. Dhe kjo kishte ndodhur në kohën kur vet pala e denoncuar z. Hasani, ka qenë Rektor dhe Kryesues i Senatit të Universitetit të Prishtinës, si autoriteti kryesor në Universitet. Edhe këtë pretendim pala e denoncuar nuk e ka kundërshtuar me asnjë provë apo fakt.

- *Pika III e denoncimit:*

Këshilli i Etikës, lidhur me *Pikën III të Denoncimit* arrin në përfundimin se deklaratimet publike të z. Hasani, në mediat elektronike dhe audiovizuele përbëjnë shkelje të rëndë të rregullave bazike të etikes për stafin akademik të Universitetit të Prishtinës. Përmes këtyre deklaratave publike i është cenuar dinjiteti dhe imazhi i Universitetit të Prishtinës dhe personelit të caktuar akademik në vazhdimësi, në mënyrë përbuzëse dhe ofenduese. Këto deklarata ofenduese të z. Hasani, janë të pa precedentë, janë tejet të dëmshme dhe me qëllime keqbërëse e denigruese.

Pretendimet e paraqitura në denoncim janë fakte të pakontestuar dhe të ditura botërisht, të argumentuara edhe me prova bindëse. Pala e denoncuar nuk ka marrë as mundin më të vogël për kundërshtimin e këtyre fakteve të prezantuara apo ndonjë revokim apo pendesë për deklarata të tilla fyese dhe atë në vazhdimësi. Për më tepër, pala e denoncuar ka vazhduar me deklarime të pamatura dhe me gjuhë të papërshtatshme dhe fyese ndaj

organeve të Universitetit dhe vetë Institucionit të Universitetit edhe pas fillimit të procedurës etike para organeve legjitime të Universitetit.

Në këtë drejtim, Këshilli i Etikës tërheq vërejtjen se, nuk është qëllimi në asnjë mënyrë kufizimi i lirisë së shprehjes apo kufizimit të saj të garantuar me nenin 40 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, por, ato pretendime të cilat i përmend z. Hasani kundrejt kolegëve, ato duhet të adresohen në mënyrë institucionale dhe mekanizmave ligjor për trajtimin e tyre.

Këshilli i Etikës ka konstatuar në procedurën e këshillimit dhe të votimit përtej çdo dyshimi të bazuar (neni 7 i Rregullores për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të UP, nr. 857, datë 11.04.2017) se deklaratimet përbuzëse dhe pa asnjë takt akademik të palës së denoncuar ndaj personelit dhe Institucionit në mënyrë të vazhdueshme konsiderohen cenim i rëndë i rregullave dhe standardeve etike, të parapara me kornizën normative të UP.

Konsekuencat e deklaratave të tij të vazhdueshme sipas rregullave jashtë UP nuk kanë qenë objekt trajtimi nga ana e Këshillit të Etikës dhe as nuk janë marrë në konsideratë në kualifikimin juridik të deklaratës së tillë.

Fillimisht është tërhequr një diferencim primar dhe atë, nëse deklaratat dhe prononcimet e tilla, të referuara në Këshill, mund të konsiderohen “shprehje e lirë e mendimit” apo përbëjnë një “deklaratë apo kritikë abuzive”, e cila nuk mund të mbulohet nga e drejta legjitime për shprehje të lirë të mendimit dhe të fjalës, të garantuara edhe me KEDNJ, në të cilën është referuar shprehimisht edhe vetë pala e denoncuar. Këshilli i Etikës vëren se deklaratat e tilla qartazi përbëjnë një kritikë fyese dhe abuzive, e drejtuar për përbuzje dhe nënvlerësim të një subjekti tjetër dhe zhvlerësim të identitetit të një subjekti.

Këshilli i Etikës konstaton se deklaratat e drejtuara të palës së denoncuar “se është duke i luftuar dukuritë negative në Universitet dhe ka të drejtën e shprehjes së lirë” nuk legjitimon sjelljen thellësisht abuzive dhe përçmuese ndaj personelit dhe Universitetit. Secili person i stafit akademik dhe jo akademik është i detyruar dhe ka përgjegjësinë për ruajtjen e imazhit të UP si brenda ashtu edhe jashtë tij. Për më tepër, UP është një institucion publik dhe si i tillë kjo ofron jo vetëm të drejtën, por edhe obligimin për mënjanimin e sjelljeve apo edhe shprehjeve të papërshtatshme me përmbajtje fyese edhe jashtë ambientit akademik (shih sidomos nenet 5 dhe 6, 13, 14, 15, 16 të Kodit të Etikës si staf akademik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”).

- Këshilli i Etikës është marrë edhe me çështjen, nëse një deklaratë e tillë mund të mbulohet nga e drejta fundamentale e njeriut për shprehje të lirë të fjalës edhe nga pozita të zhveshurit nga pozicioni si profesor në një institucion publik, përkundër faktit të detyrimit për përmbajtje të stafit akademik nga çfarëdo sjellje joetike dhe të papërshtatshme dhe jashtë objekteve të UP. Këshilli i Etikës vëren se postimet dhe

deklarimet e një kritike fyese edhe si referim me qëllimin e qartë për përçmim nuk mund të mbulohet dhe as të legjitimohet nga e drejta për liri të shprehjes. Liria e shprehjes nënkupton ofrimin e deklaratës për një fakt, por kjo e drejtë nuk ofron privilegj për kritikë abuzive dhe fyese, qartazi e drejtuar te një subjekt tjetër (sidomos dispozitat e neneve 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16 të Kodit të Etikës si staf akademik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, nr. 1/751, datë 19.07.2013).

- Gjithashtu, duke vlerësuar autoritetin dhe kompetencat e Rektorit të Universitetit të Prishtinës, të shprehura në statut (në rastin konkret kompetencat dhe autoritetin e Rektorit të përcaktuar me dispozitat e Statutit në fuqi dhe Statutit të vitit 2004 të Universitetit të Prishtinës), që konsistojnë në autoritetin kryesor menaxhues dhe reprezentativ të Universitetit, që simbolizohet me gjerdanin e Rektorit, Këshilli i Etikës konstaton se autoriteti i tillë, pritët të shoqërohet edhe me një integritet të lartë etik, gjatë ushtrimit të detyrës dhe pas përfundimit të mandatit. Për me tepër, një pozitë e tillë edhe honorifike e një ish-Rektori të UP-së kërkon sjellje shembullore dhe afirmim të vazhdueshëm të imazhit të Universitetit, si pritje legjitime për personelin e Universitetit dhe publikun e gjerë. Shfrytëzimi i këtij autoriteti për të dëmtuar imazhin e universitetit, siç është konstatuar në rastin e z. Hasani si ish-Rektor, nuk arsyeton mbajtjen e asnjë mirënjohje apo privilegji të dhënë nga Universiteti.
- Përdorimi i gjuhës përbuzëse, ofenduese dhe përçmuese ndaj kolegëve dhe Institucionit nuk është liri e shprehjes, është antivlerë. Gjuha fyese ndaj personelit përbën mohim klasik të dinjitetit të personelit dhe Institucionit dhe kjo sjellje nuk guxon të durohet askund dhe aq më pak në një ambient akademik, siç është Universiteti.
- KE ka shqyrtuar me shumë kujdes edhe shqiptimin e masave për shkelje të tilla të konstatuara. Rrethanë rënduese është se z. Hasani asnjëherë nuk është distancuar nga deklaratat e tilla dekadente ndaj personelit dhe Universitetit. Nuk është shfaqur asnjëherë as pendesa më e vogël për deklarata të tilla fyese dhe përçmuese. Nuk ka pasur as më të voglin bashkëpunim me punëdhënësin, pra Universitetin dhe organet e tij legjitime. Rrethanë tjetër rënduese në shqiptimin e masave është edhe fakti i deklarimeve të tilla të z. Hasani, haptas përbuzëse dhe përçmuese ndaj personelit dhe Institucionit dhe atë në vazhdimësi, publikisht dhe masivisht. Ndonjë rrethanë lehtësuese në shqiptimin e masës është vështirë të identifikohet, përkundër vullnetit të Këshillit.
- KE ka konstatuar se masa e ndërprerjes së punës do të mund të konsiderohej plotësisht proporcionale me shkeljet e rënda të konstatuara. Por, duke pasur parasysh konsideratat humane për gjendjen shëndetësore, KE i rekomandon Senatit akademik të përmbahet nga masa e ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe të vendos masat e rekomanduara si më lartë në dispozitiv të këtij rekomandimi.

L. M.

V. Vendimi

Këshilli i Etikës ka vendosur njëzëri si në dispozitiv të vendimit duke marrë për bazë autoritetin e legjitimuar për vendosje, duke shqyrtuar të gjitha rrethanat e rastit, në tërësinë e tyre faktike, provat e bashkangjitura, si dhe duke u bazuar në kuadrin normativ përkatës të Universitetit të Prishtinës, si Statutin e Universitetit të Prishtinës; Kodin e Etikës (nenin 17, 11, 13, 14.4) dhe Rregulloren për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të UP (neni 7 dhe nenin 6).

VI. Këshilla juridike

Kundër vendimit të Senatit të Universitetit të Prishtinës për miratimin e këtij rekomandimi të Këshillit të Etikës, pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në Këshillin Drejtues të Universitetit të Prishtinës, brenda afatit prej 30 ditësh pas pranimit të vendimit të Senatit akademik (Rregullore për masat dhe procedurat disiplinore ndaj personelit akademik të UP, neni 9).

Në emër dhe me autorizimin e Këshillit të Etikës

Kryesues: Prof. Dr. Iset Morina

